



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:107525  
Datë: 22.02.2024  
Numri i dokumentit: 05362309

**P.nr.583/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal**, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit S. P nga fsh. G komuna Pejë për shkak të veprës penale „ Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.890/2020 të dt.10.08.2020 pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 23.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit S.P, përkthyesit Šejla Čorović, me dt. 23.01.2024 merr dhe publikisht shpall, ndërsa me datë 22.02.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**S.P** me nr. personal ....., nga i ati D..... dhe nëna G..... e lindur C, i lindur me ..... në Pejë, me vendbanim në fshatin G....., komuna Pejë, i pa punë, i ..... i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel. me nr..... , i nacionalitetit serb, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse** me datë ..... rreth orës 5:00 të mëngjesit, në fshatin G..... K. Pejë seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë se d ta privoj nga jeta me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit tek personi i tillë i dëmtuari-vëllai i tij V.P në atë mënyrë që .në kohën dhe vendin e lartcekur shkon tek dritarja e dhomës së gjumit në shtëpinë e të dëmtuarit V.P ,i cili ishte duke fjetur në dhomë me bashkëshorten e tij M.P -shtetase e R.....duke e kanos me fjalët „ kam me të vra, dil jashtë nëse guxon” dhe si pasojë e këtij kërcënimi tek i dëmtuari V.P është shkaktuar frikë dhe ankth ndërsa bashkëshorten e të dëmtuarit e ofendon në baza nacionale „ .....”.

- me çka ka kryer veprë penale „ Kanosje ” nga neni 181 par.2 të KPRK-së .

Andaj, konform nenit 2, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39,40, 42, 48, 49, 69, 70, nenit 181 par.2 ,të KPRK-së , nenit 364 dhe 452 të KPPRK-së, gjykata të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

### Ashtu që të njëjtit i përcakton:

- I. DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) euro**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej **1 (një) viti**.
- II.** I pandehuri obligohet të paguaj e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **30 € (tridhjetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- IV.** Personat e autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest juridiko civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.890/2020 të dt.10.08.2020, kundër të pandehurit, S.P nga fsh. G K-Pejë, për shkak të veprës penale „Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Gjyqtarja e vetme gjykuese Gjykata, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurit S.P ,përkthyeses – praktikantes gjyqësore Šejla Čorović, me pëlqimin e palëve e në mungesë të palës së dëmtuar V,.P për të cilin gjykata përmes raportit të Stacionit Policor në G është njoftuar se i njëjti ka vdekur, çka si dëshmi gjykatës i është dorëzuar edhe certifikata e vdekjes me numër të ref. ....

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Meqenëse i pandehur hoqi dore nga leximi i aktakuzës, konform nenit 241 par.3 të KPRK-së gjykata morri aktvendim dhe aktakuzën PP/II.nr.890/2020, të dt. 10.08.2020 e konsideroi si të lexuar.

Gjykata pasi është bindur së i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë.

I pandehuri deklaroi se e ka kuptuar përmbajtjen e aktakuzës e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në bazë të aktakuzës.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, deklaroi se pajtohet me deklaratën e të pandehurit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pasi i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Pas kësaj, gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e pranimin të fajësisë, se vullnetarisht e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është në përputhje me gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, miratoi pranimin e fajësisë konform nenit 242 par.6 ngase e njëjta përputhet me prova materiale si në vijim: Raportin policor të përpiluar nga zyrtari policor Radosav Petrovic#8208, datë 11.06.2020, Deklaratën e të dëmtuarit V.P të dhënë në polici me datë 11.06.2020, Deklaratën e dëshmitares M.P të dhënë në polici me datë 11.06.2020 dhe Procesverbalin e marrjes në pyetje të të pandehurit S.P të dhënë në polici me datë 11.06.2020..

Prokurori i shtetit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit i propozoi gjykatës që si rrethane lehtësuese ndaj të pandehurit të merr pranimin e fajësisë, ndërsa rrethanat rënduese ia lë në vlerësim gjykatës.

I pandehuri i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese ndaj tij të merr pranimin e fajësisë.

Me rastin e vendimit mbi llojin dhe matjen e lartësisë së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e sanksionit penal dhe si rrethana lehtësuese për të pandehurin morri parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte gjatë seancës, faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata morri faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi lartësinë e dënimit, gjykata shqiptoj dënim me kusht, duke konsideruar se edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 38 i KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor dhe atë në shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në shumën prej **20 € (njëzetë euro)**, të cilat i pandehuri obligohet t'i paguaj brenda afatit prej 15 ( pesëmbëdhjetë ) ditësh, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata, sipas certifikatës se vdekjes numër 65, lëshuar me datë 20.11.2023, nga Zyra e Gjendjes Civile në G....., vërtetoi faktin se pala e dëmtuar V.P ka vdekur me datë 08.12.2020, andaj gjykata për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzoi personat e autorizuar në kontest juridiko civil, e në bazë të nenit 457, 458 dhe 462 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**Divizioni Penal**  
**P.nr.583/20, me datë 22.02.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

---

Gylaj Nepola

---

Ilda Cucović Sahatçiu

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.